

SHOQËRIA TREGTARE ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR

“Boost Outsourcing Solutions”

Durrës – Albania

**AKT THEMELIMI**

Në Durrës, sot me datë **04.01.2022** (dymijë e njëzet e dy), ditë e Martë, ne shtetasit Shqipëtar me ketë identitet:

**Z. Ramazan KAPXHIU**, atësia Armand i datëlindjes 11.11.1990, lindur në Durrës, dhe banues në Durrës, mbajtës i dokumentit të identifikimit me Nr ID J01111057W tel 0694322076 dhe

**Z. Mariglen QORRI**, atësia Merdan i datelindjes 12.01.1996 , lindur në Sopot, dhe banues në Durrës, mbajtës i dokumentit të identifikimit me Nr ID J60112012J tel 0674972355

duke u bazuar në:

- \* Vullnetin tonë të lirë, të plotë, të sinqertë, dhe në inisiativen e lire private,
  - \* Ne Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë dhe Kodin Civil në fuqi,
  - \* Ne Ligjin Nr.9901 date 14.04.2008 “Për Shoqëritë Tregtare”,
  - \* Ne Ligjin Nr.9723 date 03.05.2007 “Për Qendrën Kombëtare të Biznesit”
- Vendosëm si me poshte:

**NENI 1**

**Formimin e shoqërisë** me përgjegjësi të kufizuar e cila do të mbajë emrin “**Boost Outsourcing Solutions**” shpk, emërtim i cili do të jetë i stampuar dhe ne vulen e saj.

**NENI 2**

**Selia Qendrore e Shoqërisë “Boost Outsourcing Solutions”** sh.p.k është në adresën, **Rruga Hafiz Podgorica Ndertesa 16, Hyrja 7, Apartamenti nr.17, Durrës**

**NENI 3**

Shoqëria e shtrin aktivitetin e saj tregtar në të gjithë juridiksionin territorial të Republikës së Shqipërisë si dhe jashtë shtetit në cdo vend të Komunitetit Europian, etj.


Me Vendim të Asamblese se Ortakeve mund të krijohen ose anulohen (në rast se janë çelur) Seli, Filiale, Agjensi dhe Perfaqësi si në qytete të tjera të Shqipërisë dhe jashtë vendit.

Njësite e tjera Strukturore të Shoqërisë, si Degë apo Përfaqësi qoftë jashtë shtetit krijohen kur një gjë të tillë e parashikon dhe lejon edhe legjislacioni i vendeve të huaja, normat e së drejtës ndërkombetare private dhe parimet e reciprocitetit tregtar mes vendeve të ndryshme.

**NENI 4**

**Kapitali Themeltar fillestar** i Shoqërisë do të jetë **100.000 Lekë** (njëqindmijë lekë), i zotëruar nga ortakët si më poshtë:

Nr personal	Emri, mbiemri	% që zotëron	Nr kuotave që zotëron
J01111057W	Ramazan Kapxhiu	55%	1 kuotë
J60112012J	Mariglen Qorri	45%	1 kuotë

Mariglen Qorri  


Ramazan Kapxhiu  


Kapitali i shoqërisë është i ndarë në 2 (dy) kuota, ku pjesëmarrja e themeluesve në kapitalin e shoqërisë është në përputhje me kontributin e tyre si me poshte:

- Ortaku **z.Ramazan KAPXHIU** ka ofruar një kontribut në para të barabartë me 55.000 (pesëdhjetëepesëmijë) lekë zotërues i 1 (një) kuote, që përbën 55% të kapitalit themeltar të shoqërisë.
- Ortaku **z.Mariglen QORRI** ka ofruar një kontribut në para të barabarte me 45.000 (dyzetepesëmijë) lekë zotërues i 1 (një) kuote që përbën 45% të kapitalit themeltar të shoqërisë.

Ky kapital është i vlefshëm për regjistrimin e shoqërisë sipas nenit 43 të ligjit nr.9723, date 03.05.2007 "Per Qendren Kombetare të Biznesit"

Ortakët kanë pavarësi ligjore, organizative si dhe të drejta pronësie mbi çdo lloj kapitali, mjete monetare, si dhe mbi çdo lloj pasurie tjetër të fituar në rrugë të ligjshme.

Shoqëria përgjigjet vetëm me Kapitalin e saj.

#### NENI 5

Kapitali nuk mund të jetë kurrë i perfaqësuar me Letra me vlerë dhe derdhja e Kapitalit themeltar të Shoqërisë, bëhet para kërkesës drejtuar **Qendres Kombetare të Biznesit** për njohjen dhe regjistrimin e saj si Person Juridik.

#### NENI 6

**Kohëzgjatja** e ushtrimit të aktivitetit të Shoqërisë është **PA AFAT**, duke filluar aktivitetin e saj nga dita e Shpalljes së saj Person Juridik.

Me Vendim të Asamblesë së Ortakëve kohëzgjatja e ushtrimit të aktivitetit të Shoqërisë mund të ndryshojë, dhe ky Vendim i dërgohet menjëherë për depozitim Qendres Kombëtare të Biznesit, kompetente për të bërë shënimet e nevojshme në Rregjistrin e Shoqërive Tregtare.

#### NENI 7

Shoqëria e zhvillon veprimtarinë e saj tregtare në përputhje të plotë me Legjislacionin Shqiptar në fuqi si dhe mbi bazën e këtij AKTI Themelimi si dhe Statutit e saj.

#### NENI 8

Shoqëria çel llogari Bankare në monedhë vendi dhe çdo lloj valute, në Banka vendase ose të huaja, private apo shtetërore, me qëllim për të kryer veprimet e nevojshme për ushtrimin dhe përballimin financiar të aktivitetit të saj.

Ortakët dhe Administratori Përgjithshëm i caktuar prej tyre, depozitojnë faksimilet e firmave të tyre origjinale në Bankat ku është çelur llogaria dhe tërheqja e pjesëve të saj bëhet kur dokumenti bankar është firmosur nga njeri Ortak që është caktuar dhe si Administrator i Shoqërisë. Në rastin kur Ortaket kanë caktuar me shumë se një Administrator, i cili është jashtë ortakërisë, dokumenti bankar dhe çdo likuidim apo pagesë nënshkruhet nga Ortaku që është Administrator i Përgjithshëm i Shoqërisë dhe nga Administratori jashtë Shoqërisë.

#### NENI 9

**Pjesët e Kapitalit Themeltar**, janë lirish të transferueshme në rrugë trashëgimie sipas dispozitave të Kodit Civil.

Transferimet e pjesëve të Kapitalit Themeltar, duhet të jenë të vërtetuara me Kontrate Noteriale dhe për një gjë të tillë Ortaket duhet të marrin paraprakisht Vendim me shkrim, i cili ushtron efektet juridike vepruese të tij, vetëm në rast se është legalizuar nga një Noter.

Shoqëria dhe të tretët, duhet të respektojnë këto Transferime sapo tu behen të ditura.

Mariglen Qorri  


Ramazan Kapxhiu  


#### NENI 10

### Shoqëria krijohet për të ushtruar aktivitetin e saj tregtar në këto Drejtime:

Shërbime online marketing, outsourcing, promocione, shërbim klienti, web design, konsulencë për marketing, etj.

#### NENI 11

Me Vendim të Asamblesë së Ortakëve, shoqëria mund të zgjerohet duke pranuar një ose më shumë ortakë të tjerë, shtetas Shqipëtar apo të huaj, ose të bashkohet me një Shoqëri tjetër tregtare si brenda vendit dhe jashtë shtetit.

#### NENI 12

**Asambleja e Ortakëve** është Organi më i lartë **Drejtuës** dhe **Vendimor** i Shoqërisë dhe ajo ushtron të gjitha kompetencat që Ligji “Per Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare” i njeh Asamblesë së Ortakëve që janë krijuar me Ortakëri.

Ortakët në mirekuptim dhe duke vënë paraprakisht në dijeni njeri tjetrin mund t’ja delegojnë kompetencat një ose më shumë Administratorëve të caktuar prej tyre ose dhe një Personi fizik apo Juridik vendas apo i huaj dhe jashte ortakërisë së Shoqërisë, mbi bazen e **Prokurës**, të bëre me Akt Noterial.

#### NENI 13

Administrator i Përgjithshëm i Shoqërisë, caktohet :

**Z. Mariglen QORRI**, atësia Merdan, i datelindjes 12.01.1996 , lindur në Sopot, dhe banues në Durrës, mbajtës i dokumentit të identifikimit me Nr ID J60112012J tel 0674972355, **me afat emërimi 1-vjeçar** nga data 04.01.2022 deri në datën 04.01.2023 .

#### NENI 14

**Ky AKT Themelimi** u redaktua ne 5 ekzemplare me përmbajtje dhe vlera te njëjta juridike në gjuhën Shqipe dhe është i vlefshëm de jure, kur në të gjithë faqet e tij është vendosur emri, mbiemri dhe firma origjinle e Ortakëve Themelues.

ORTAKËT THEMELUES TË SHOQËRISË TREGTARE  
&  
MIRATUES TË KËTIJ AKTI THEMELIMI

( z. Ramazan KAPXHIU )



( z. Mariglen QORRI )

